


Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Agjencia Qendrore e Prokurimit / Centralna Agjencia Nabavke
Central Procurement Agency

DATË/A:	28.04.2016
PËR/ZA/TO:	Autoritetet Kontraktuese
NGA/OD/FROM:	Mursel Racaj, Drejtor i Agjencisë Qendrore të Prokurimit 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për Autoritetet Kontraktuese (AK) te nivelit Lokal dhe Qendror lidhur me zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit; Furnizim me material zyrtare, Shërbime të fotokopjes, Furnizim me artikuj ushqimor.

Të nderuar,

Në përputhje me nenin 95 të LPP, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar listën e mallrave të përdorimit të përbashkët. Kjo liste është miratuar me Udhëzimin Administrativ (UA) nr. 05/2016 i cili mund të shkarkohet nga webfaqja e AQP-se dhe webfaqja e KRPP-se.

Agjencia Qendrore e Prokurimit fillimisht do të inicioj aktivitetet e prokurimit të centralizuar për AK në nivel lokal dhe qendror për:

- **Furnizim me material zyrtarë në nivel lokal**
- **Furnizim me artikuj ushqimor në nivel lokal dhe**
- **Shërbime të fotokopjes në nivele qendrore**

Si rrjedhojë, AQP njofton të gjitha AK të nivelit lokal dhe qendror se:

1. Kjo liste e aprovuar është obligative për të gjitha AK të nivelit lokal, Shtojca #2 (a) e UA, që do të thotë se AK të nivelit lokal dhe qendrore nuk mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre të prokurimit për kategoritë e përcaktuara në UA por se këto aktivitete të prokurimit do të udhëhiqen nga Agjencia Qendrore e Prokurimit.
2. Në rast se kontratat e juaja aktuale do të skadojnë në një të ardhme të afërt AK, duhet të iniciojnë aktivitetet e prokurimit për kategoritë e cekura më lartë për një kohëzgjatje prej jo më shumë se 1 (një) vit në mënyrë që kontrata e re e AK mos të përkojë me kontratën e prokurimit të përbashkët.
3. Për kategoritë e përcaktuara më lartë, KRPP nuk do të publikoj Njoftimet për Kontrate, të dorëzuar nga AK të nivelit lokal, nëse kohëzgjatja e kontratave të parapara në ato Njoftime për Kontrate është më shumë se 1 (një) vit.

Me respekt,